

... të fëmijëve në transmetime
... esën e Autoritetit të Med
... ive që prej muajit prill ka
... tur më **Buletini i** shumë
... mendime **Lëshillit të** për
... cilave kanë **Ankesave.** N
... të drejtë të kërkojë, të het
... të marrë dhe të ndajë info
... dhe ide, pa asnjë lloj censu
... dios, tu dhe mjeteve të tjer
... ikimit audioviziv apo ndor
... tjetër bazuar në përzgjed
... m nëse këtë e bën në kuad
... timit të sundin
... tave të njeriut. **MM**
... me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

NR. 4

Dërbajtja

Hyrja	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave	06
SEKSIONI I	
Ankesa me subjekt cenimi i të drejtave të fëmijëve	09
SEKSIONI II	
Ankesa me subjekt cenimi i rregullave të etikës	16
SEKSIONI III	
Ankesa me subjekt komunikimet me natyrë tregtare	24
SEKSIONI IV	
Ankesa të tjera	30
SEKSIONI V	
Ankesat e rrëzuara	36
SEKSIONI VI	
Kërkesa për informacion	39

Dy fjalë

në vend të hyrjes

Në këtë epokë të bollëkut me informacion, besueshmëria mbetet komponenti më i rëndësishëm në marrëdhëniet që ngrihen mes medias dhe audiencës. Por na duhet ta pranojmë se, ruajtja e një niveli të lartë të kësaj besueshmërie po bëhet gjithmonë e më sfiduese në një botë të mbushur me filluska e filtra informacioni dhe me newsroom-e, ku fabrikohen shumë më lehtë lajme të rreme apo jo. Ndaj, matja e nivelit të besueshmërisë është thelbësore për përcjelljen e perceptimeve të qytetarëve mbi organizatat që hartojnë strategjitë në media e deri produktin e saj. Kjo është vendimtare për ndërtimin e audiencës dhe e dobishme për planifikimin strategjik të zhvillimeve mediale në vendet, anëtare në EBU, mes tyre edhe Shqipëria.

Sapo ka përfunduar një hulumtim serioz, i cili bazohet në të dhënat e publikuara në sondazhin e 86-të të Eurobarometrit. Raporti jep një ide të perceptimit të qytetarëve evropianë mbi besueshmërinë e disa llojeve të mediave, përfshirë shtetet anëtare të BE-së, vendet e pranuara dhe ato kandidatë. Një sondazh mbi besimin në media u zhvillua nga Shërbimi i Inteligjencës së Medias pranë EBU-së (Unioni i Transmetuesve Publik të Evropës) për të përfutur një ide më konkrete, mbi nivelin e besueshmërisë që media ka tek qytetarët në secilin vend, pavarësisht nga llojet e ndryshme të saj.

Ndërsa besimi tek mediat në tërësi mund të ketë shënuar nivelin më të ulët në historikun e saj gjatë viteve të fundit, ky studim i EBU-së ka zbuluar së fundmi se, në mediat tradicionale (televizion dhe shtyp i shkruar) besimi i publikut, ka shënuar progres në rritje. Në këtë përfundim kanë arritur ekspertët e fushës, të cilët vazhdojnë të këmbëngulin bazuar në ekspertizën e tyre se, megjithatë, besimi i

njerëzve në median e re vazhdon të shënojë rënie. 61% për qind e vendeve evropiane nuk i zënë besë internetit, ndërsa 97 për qind e tyre nuk u besojnë aspak rrjeteve sociale. Studimi i EBU me përkufizimin "Të besosh në Media 2018" tregon se si hendeku i besimit të njerëzve mes medias tradicionale dhe asaj të re vazhdon të rritet. Media elektronike gjithsesi vazhdon të mbetet formati më i besuar; 59 % e njerëzve priren të kenë besim tek radio (shifër e vlefshme për 2017-n) dhe 51 % e tyre besojnë tek TV (është shënuar një rritje prej 1% për vitin e kaluar). Këto shifra sigurisht vlejné për vendet e BE-së. Prej këtij studimi është mësuar gjithashtu se besimi në shtypin e shkruar, gjithashtu, është përmirësuar ngadalë gjatë pesë viteve të fundit. 47% e qytetarëve brenda BE-së besojnë në këtë lloj formati tradicional. Ndër të tjera, ekspertët paralajmërojnë se besimi i njerëzve tek interneti dhe në mediat sociale është shkatërruar nga lajmi i rremë (fake news), keqinformimi dhe dezinformimi. Tani vetëm 34% e qytetarëve të BE-së i besojnë internetit dhe 20% e tyre u besojnë rrjeteve sociale (respektivisht 36 % dhe 21 % krahasuar me vitin 2017). Prej studimit, gjithashtu është arritur në përfundimin se besimi i qytetarëve evropianë në mediat elektronike është i lidhur ngushtë me një shtyp të lirë dhe të pavarur. Sa më i lartë niveli i besimit tek radio dhe TV i një vendi, aq më e madhe liria e shtypit ka tendencë të jetë.

Projekti 'Të besosh në Media 2018' bazohet në të dhënat e publikuara në sondazhin e 88-të të Eurobarometrit dhe jep një ide të perceptimit të qytetarëve evropianë mbi nivelin e besueshmërisë së llojeve të ndryshme të mediave. Anketa përmban rreth 1000 intervista të drejtpërdrejta dhe është realizuar në 33 vende evropiane, anëtare ose kandidatë për anëtarësim.

Shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë se subjektet audiovizive kanë cenuar apo shkelur Ligjin nr. 97/2013, apo kodet dhe rregulloret e miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.

Por që të mund të ngrihet një ankesë duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ankohet. Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden lehtësisht në faqen zyrtare të AMA-s: www.ama.gov.al.

Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën "Formular ankese për shkeljen e Kodit të Transmetimit", plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: info@ama.gov.al. Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë duke kërkuar kështu dhe një mendim nga ana e subjektit. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit audioviziv ose, nëse ai nuk përgjigjet atëherë ankesa mund të referohet në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankese që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të AMA-s, si Drejtoria Juridike, Drejtoria e Programeve dhe në disa raste ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet *Buletini i Këshillit të Ankesave*. Dhe ky është publikimi ynë i katërt që prej fillimeve të tij. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.

Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave



Ankesa me
subjekt
cenimi i të
drejtave
të femijëve

Ankesa e paraqitur: **Shtetasja A.B**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV Channel 1	Kinematografi	16.01.2018

1. Programi

Shtetasja A.B. iu drejtua me një ankesë, përmes postës elektronike zyrtare, Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në lidhje me transmetimin e një prodhimi kinematografik të papërshtatshëm në TV Channel 1, në Shkodër.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi parimet e Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Kodin e Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja pretendon se një prodhim kinematografik është transmetuar në orën 14.00 nga Televizioni TV Channel 1, i cili ka pasur përmbajtje të palejuar nga parimet e ligjit dhe Kodit të Transmetimit në atë orar.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Me marrjen e kësaj Ankesë, Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim materialin video të transmetuar nga Televizioni TV Channel 1. Këshilli i Ankesave konstatoi se transmetimi

i filmit në fjalë, në orarin e sipërcituar ishte në shkelje të kërkesave ligjore. Programe ose filma që mund të cenojnë apo dëmtojnë fëmijët, duhet të jepen vetëm pas orës 22.00, dhe gjatë gjithë kohës duhen shoqëruar me shenjën përkatëse paralajmëruese. Kjo kërkesë e Kodit të Transmetimit është e sanksionuar në pikën 5.34, Seksioni 5, ku thuhet: *"OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 22.00 - 06.00)".*

Televizionit iu rikujtua se, në pikën 5.48 të Kodit përcaktohen edhe llojet e shenjave paralajmëruese që duhen përdorur, shenja që pavarësisht formave të ndryshme të zgjidhjes grafike, ngjyra dhe qartësia e tyre, janë elementë të pandryshueshëm dhe të detyrueshëm për të gjithë.

Sa më sipër, AMA i tërhoqi vëmendjen për të mos përsëritur raste të tilla, në të kundërt Autoriteti paralajmëroi se do të vijonte me procedurat e parashikuara nga legjislati në fuqi.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV Klan	Zonë e Lirë	09.01.2018

1. Programi

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve iu drejtua me një ankesë në postën elektronike zyrtare të institucionit në lidhje me intervistimin e një fëmije autik në emisionin "Zonë e lirë" në TV Klan.

2. Kategoria

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve shprehu shqetësimin se transmetimi ka shkelur parime të sanksionuara në konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës", Ligjin nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", Ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Kodin e Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Agjencia pretendon se një qytetar pranë saj ka kërkuar interpretim të situatës, në lidhje me shfaqjen e një interviste me një fëmijë autik në emisionin "Zonë e lirë". Agjencia konstaton se fëmija ka shkuar me dëshirë në emision, ka qenë i shoqëruar nga një psikolog, si dhe duket i lirshëm dhe i lirë në emision. Shqetësuese për Agjencinë ishte etiketimi i fëmijës gjatë emisionit si "fëmijë autik" apo për interpretimin e moderatorit gjatë emisionit nëse ky fëmijë është vërtet autik apo normal. Sipas Agjencisë, sipas pikës 5.17, në Kodin e Transmetimit, "Intervistimi i fëmijës" citohet që gjatë intervistimit të fëmijëve "... duhet të shmangen pyetjet ose komentet paragjyquese, të rrezikshme për fëmijën, ose ato që i sjellin ndërmend ngjarje traumatike".

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas shqyrtimit të materialit video të emisionit "Zonë e lirë", intervistimi i fëmijës në studio u pa se është korrekt dhe në bazë pikave të Kodit të Transmetimit. Seksioni 5 i Kodit të Transmetimit i dedikohet vetëm mënyrës së intervistimit të fëmijës që në këtë transmetim janë respektuar. Fëmija është informuar për intervistimin, është në prani të një personi psikolog dhe, për më tepër, nuk tentohet të abuzohet me të përmes pyetjeve.

Pikat 5.10 dhe 5.11 shprehen qartë:

5.10 *"Intervistimi i fëmijëve duhet të bëhet me praninë e përfaqësuesit të tij ligjor ose një personi të caktuar prej tij"*.

5.11 *"Fëmijës si dhe përfaqësuesit ligjor duhet t'i shpjegohet paraprakisht qëllimi i intervistës, si dhe përdorimi i mundshëm i saj. Si për fëmijën, ashtu edhe për përfaqësuesin ligjor, duhet të respektohet e drejta e tyre për të mos pranuar të intervistohen"*.

Për më tepër, intervista e fëmijës në fjalë, por edhe të fëmijëve të tjerë autikë, ka pasur si qëllim sensibilizimin e shoqërisë për këtë problem të madh. Në studio, krahas prindërve, kanë qenë të pranishëm edhe persona të njohur publikë që flasin për eksperiencat e tyre. Kodi i Transmetimit përligj interesin publik në transmetime të ngjashme dhe në rastin konkret, ka një interes publik që të trajtohet çështja e autizmit në media dhe në shoqëri.

Pika 1.16 e Kodit të Transmetimit kërkon që transmetimet të promovojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, dhe pavarësisht mënyrës së interpretimit të disa komenteve në studio, emisioni ia ka arritur të promovojë mirëqenien e fëmijëve autikë.

Pika 1.16 e Kodit shprehet: *"Transmetimet audiovizive duhet të promovojnë dhe të mbrojnë mirëqenien, shëndetin e zhvillimin harmonik moral e fizik të fëmijëve. Parimi i interesit më të lartë për mbrojtjen e fëmijëve duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për transmetimin, programimin, pjesëmarrjen apo informacionet për ta, në mediat audio dhe/ose audiovizive"*.

Ankesa e paraqitur:

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Subjekti audioviziv

Televizioni Klan
Televizioni A1 Report
Televizioni ABC News

Programi

Edicion informativ
Edicion informativ
Edicion informativ

Data

03.03.2018
03.03.2018
03.03.2018

1. Programi

Programet përfshijnë informacione të ndryshme nga vendi dhe bota, intervista dhe biseda në studio, etj. Ankesa lidhet me publikimin e një lajmi në edicionet informative të këtyre subjekteve audiovizive. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është cenimi i të drejtave të fëmijës, publikimi i të dhënave të ndjeshme dhe shkelje e privatësisë së fëmijës.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Gjithashtu, ajo bazohet në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33, germa dh); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

3. Përmbledhje e ankesës

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF), në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sjell në vëmendje kronikat mbi vrasjen e një adoleshenti, nga bashkëmoshatarit i tij, ngjarje e ndodhur në Spitallë të Durrësit.

Subjekti ankues thekson se, tre televizionet e kanë publikuar lajmin, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së fëmijëve, pasi autori i dyshuar i krimit është identifikuar me gjeneralitete, si dhe janë publikuar pamje të banesës së tij. Për më tepër, sipas ankuesit, identifikimi i tij gjithashtu bëhet më i qartë edhe përmes publikimit të intervistës së babait të djalit, autor i dyshuar i veprës penale, që përbën gjithashtu cenim të të drejtave të fëmijës.

Agjencia pretendon se, nga mënyra si është publikuar lajmi janë shkelur të drejtat e fëmijës, parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës", si dhe Ligji nr. 10347 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", për ruajtje të privatësisë së fëmijës.

Gjithashtu, ASHMDF ngre shqetësimin se informacione të tilla, të bëra publike, i identifikojnë lehtësisht fëmijët, që janë viktimë ose autorë të ngjarjeve të rënda, dhe ndikojnë në rehabilitimin e tyre më pas.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi pamjet filmike të të gjithë OSHMA-ve në lidhje me lajmin e transmetuar për vrasjen e të miturit në Spitallë të Durrësit dhe i dërgoi Agjencisë përgjigjen e mëposhtme:

Pas këqyrjes së kujdesshme të detajeve të transmetuara, Këshilli i Ankesave mendon se rasti në fjalë nuk mund të kategorizohet vetëm si një shkelje e të drejtave të fëmijëve. Lajmi i transmetuar paralajmëron mundësinë e një përshkallëzimi të konfliktit mes dy familjeve, ndaj në këtë rast, raportimi në media përbën një interes publik, për të parandaluar ngjarje të tjera të rënda.

Kodi i Transmetimit përlij cenimin e disa parimeve, në rast se transmetimi përbën interes publik. Në rastin konkret, të miturit identifikohen nga intervista e xhaxhait të viktimës apo babait të autorit, por transmetimi i tyre nga media paralajmëron mundësinë e hakmarrjes mes dy familjeve.

Në pikën 3.5 të Kodit të Transmetimit, zbulimi apo paralajmërimi i një krimi përbën interes publik dhe konkretisht: *"Interesi publik përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: i) Zbulimin apo ekspozimin e krimit apo të padrejtësisë serioze. ii) Mbrojtjen e shëndetit publik dhe të sigurisë. iii) Parandalimin e publikut nga mashtrimi me një veprim apo deklaratë të një individi apo organizate. iv) Garantimin për të pasur akses në informacione që lehtësojnë formimin e opinionit të qytetarëve për çështjet politike, ekonomike dhe sociale. Për qëllimet e këtij Kodi, interesi publik, nuk duhet të justifikojë pasaktësitë dhe spekulimet".*

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave mendon se transmetimi i ngjarjes së rëndë të vrasjes të të miturit në Durrës përbën interes publik nisur edhe nga specifikat e rastit. Ndonëse kemi të bëjmë me identifikim të viktimës dhe autorit të dyshuar, transmetimet kanë pasur në fokus përshkallëzimin e konfliktit mes dy familjeve, çka sensibilizimi publik mund të ndihmojë në parandalimin e tij.



Ankesa e paraqitur: **Shtetasja E.I.**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Të gjitha

Të gjitha

17.02.2018

Ankesa me
subjekt
"cënimi i
rregullave
të etikës"

1. Programi

Shtetasja E.I. iu drejtua me një ankesë institucionin në lidhje me standardin e gjuhës shqipe në transmetimet audivizive.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi parimet e ligjit për të drejtën e informimit si dhe në bazë të kërkesave mbi përmbajtjen audivizive, të përcaktuar në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe Kodin e Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja kërkon nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizive të ndërhyjë në të gjitha OSHMA-të për shkrimin e saktë të gjuhës shqipe në të gjitha transmetimet audivizive. Sipas saj, problem mbetet në veçanti përdorimi i germave "ë" dhe "ç", që përdoren shumë pak në këto transmetime.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Me marrjen e kësaj ankesë dhe në konsultim me Drejtorinë e Programeve, Këshilli i Ankesave, vendosi t'u dërgojë një shkresë të gjitha OSHMA-ve:

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i kanë mbërritur herë pas here shqetësime dhe ankesa lidhur me shkrimin e pasaktë të gjuhës shqipe, gjatë emisioneve që transmetohen në televizionet tuaja.

Ankesat dhe shqetësimet lidhen kryesisht me titujt dhe titrat e emisioneve, ku shpesh nuk përdoren shkronjat 'Ë', 'ë', "Ç" dhe 'ç'. Pas vëzhgimeve të Këshillit të Ankesave, dhe duke i konsideruar të drejta shqetësimet dhe ankesat e mbërritura, ju rikujtojmë se një nga detyrimet e transmetimeve audiovizive është respektimi i gjuhës shqipe.

Kodi i Transmetimit për median audiovizive, në Seksionin 1, Parimet Themelore, pika 1.8, përcakton qartësisht se: "Në të gjithë llojet e transmetimeve audiovizive të respektohet standardi letrar i gjuhës shqipe". Këshilli i Ankesave pranë AMA-s ka kërkuar respektimin e Kodit të Transmetimit, në të kundërt, paralajmëron për sanksione sipas ligjit.

Ankesa e paraqitur: **Shtetasja E.S.**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV Best Channel	Lajmet	05.02.2018

1. Programi

Shtetasi E.S. iu drejtua me një ankesë në postën elektronike zyrtare të institucionit në lidhje me transmetimin e një lajmi në edicionin e lajmeve të Tv Best Channel në Elbasan.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi parimet e ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe Kodin e Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi pretendon se në lajmet e këtij subjekti audioviziv është transmetuar një video me pamjet e një aksidenti. Sipas pretendimeve të tij, pamjet janë të rënda dhe të pafiltruara nga ana e stafit të televizionit.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Me marrjen e kësaj anese, Këshilli i Ankesave këqyri materialin video të transmetuar nga televizioni Best Channel në Elbasan dhe konstatoi se, në edicionin e lajmeve të datës

05.02.2018, është shfaqur një kronikë lajmesh e papërshtatshme me pamjet e një kamera sigurie për një aksident të rëndë, ndodhur në qytetin e Elbasanit.

Pasi shqyrtoi me kujdes materialin video përkatës, Këshilli i Ankesave konstatoi se shfaqja e pamjeve të aksidentit janë mjaft të rënda dhe në shkelje të parimeve etike të Kodit të Transmetimit, por në radhë të parë të Kodit Etik të gazetarit.

Pika 4.14 e Kodit të Transmetimit thuhet se "OSHMA-të duhet të marrin në konsideratë ndjeshmërinë e publikut në rastet e fatkeqësive, katastrofave, aksidenteve, duke u dhënë përparësi operacioneve të shpëtimit dhe mbështetjes". Shfaqja e këtyre pamjeve pas aksidentit me pasojë vdekjen prek dinjitetin e viktimave dhe të familjarëve të tyre.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s mori masa për tërheqjen e vëmendjes për të qenë më të kujdesshëm në transmetimet e ardhshme, dhe kërkoi ndalimin e publikimit të së njëjtës video pa filtra, si dhe të heqjes së saj nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur: **Shtetasja A.A.**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizioni Ora News	Emisioni "Boom"	19.02.2018/27.03.2018

1. Programi

Emision investigativ që trajton tema sociale nga realiteti shqiptar dhe probleme të ndryshme të qytetarëve. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është shkelja e dinjitetit dhe të drejtave e lirive të tjera themelore të njeriut dhe transmetim i kronikave të njëanshme.

2. Kategoria

Ankesa bazohet mbi disa pika të Kodit të Transmetimit, e më konkretisht pika 1.3 e Seksionit "Parime Themelore", pika 3.1 e Seksionit "E drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të drejtave personale", si dhe pika 4.5 e Seksionit "Transmetimi i programeve informative".

3. Përmbledhja e ankesës

Ankuesi nënvizon se, "Boom", në dy emisione të tij ku ka trajtuar një aksident automobilistik të ndodhur në aksin Levan-Tepelenë, më 28.09.2017, ka prekur të drejtën e tij të privatësisë dhe ka transmetuar kronika të pabalancuara, pra të njëanshme.

Sipas ankuesit, i cili është në procedim gjyqësor, për shkak se gjatë aksidentit ka patur një viktimë, ai nuk është kontaktuar në asnjë moment nga redaksia e emisionit "Boom" për t'u prononcuar për këtë çështje dhe për të paraqitur pretendimet e tij.

Zoti A.A. ankohet se emisioni në fjalë ka shkelur Kodin e Transmetimit, në tri pika të të cilit (pika 1.3, 3.1 dhe 4.5) thuhet:

"Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut";

"Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale. Përfshirja në jetën publike nuk i përjashton individët nga e drejta për privatësi, përveç rasteve kur rrethanat e këtyre mund të ndikojnë në performancën e tyre ose në përshtatjen merolet publike që mbajnë ose kërkojnë";

"Të gjitha lajmet e transmetuara të publikohen në mënyrë objektive dhe të paanshme".

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së kësaj ankesë, Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialet përkatëse filmike dhe nuk konstatoi shkelje të Kodit të Transmetimit. Megjithatë, i dërgoi Televizionit Ora News një shkresë, e cila iu dërgua edhe ankuesit.

Duke vënë në dukje pretendimet e z. A.A., Këshilli i Ankesave, i rikujtoi televizionit detyrimet që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit i Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ky Kod, i miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 220, datë 11.12.2017, i detyron OSHMA-të që, çdo informacion i transmetuar të jetë i vërtetë, i saktë dhe i balancuar, duke respektuar të drejtën e korrektimit të informacionit dhe të mbrojtjes së konfidencialitetit.

Seksioni 3 i Kodit të Transmetimit, ndër të tjera parashikon: *"Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale"*.

Në këto kushte, AMA çmoi se zotit A.A. duhet t'i jepet mundësia nga televizioni për të paraqitur pretendimet e tij.

Informacion shtesë

Pas shkresës së dërguar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive për Televizionin "Ora News", redaksia e emisionit "Boom" dërgoi një përgjigje, përmes së cilës evidentonte dy momente kyçe:

Së pari, edhe më herët, redaksia e këtij emisioni i kishte dhënë mundësi zotit A.A. mundësinë për të shprehur pretendimet e tij rreth çështjes së trajtuar nga "Boom";

Së dyti, në rrjedhim të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit, emisioni është i

gatshëm edhe në vazhdimësi për t'i dhënë ankuesit mundësinë për t'u shprehur.

Redaksia e emisionit "Boom", në përgjigjen e saj, pretendon se "në asnjë rast nuk ka bërë interpretime, por ka rikrijuar skenën e aksidentit, duke u nisur nga këqyrja e vendngjarjes, e cila është e dokumentuar menjëherë pas ndodhjes së aksidentit, material që më pas i ka kaluar prokurorisë".

Ndërkaq, edhe z. A.A. depozitoi në AMA një tjetër ankesë, kësaj radhe drejtuar Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Përmes kësaj ankesë, ai kundërshtonte procedurën e ndjekur nga Këshilli i Ankesave për trajtimin e ankesës së tij dhe se nuk ishte dakord me analizën e këtij rasti nga Këshilli.

Në këto kushte, Këshilli i Ankesave përgatiti për Bordin relacionin e mëposhtëm:

Shtetasi A.A. paraqiti pranë AMA-s dhe Këshillit të Ankesave, një ankesë në datën 03.04. 2018, me anë të së cilës pretendonte se emisioni investigativ-satirik "Boom" në Televizionin "Ora News" kishte transmetuar në dy paraqitje të tij të ndryshme, mbi personin në fjalë, dy kronika të pabalancuara (të njëanshme, sipas tij), si dhe duke prekur të drejtën e tij të privatësisë.

Konkretisht, zoti A.A. shkruante se kishte pësuar një aksident automobilistik në aksin rrugor Levan-Tepelenë, ku si pasojë një qytetar kishte humbur jetën. Ndaj autorit të ngjarjes aktualisht është duke vijuar procedimi penal. Sipas tij, ankuesi pretendon ndër të tjera se në dy emisionet e "Boom", është shkelur e drejta e prezumimit të pafajësisë, ndërkohë që gjykata nuk ka dhënë ende një vendim. Ai i referohet Kodit të Transmetimit, duke shkruar se emisioni "Boom" ka shkelur disa nga pikat e seksioneve të tij:

Seksioni 1 (pika 3)

1.3 *Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut.*

Seksioni 3 (pika 1)

3.1 *Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale. Përfshirja në jetën publike nuk i përjashton individët nga e drejta për privatësi, përveç rasteve kur rrethanat e këtyre mund të ndikojnë në performancën e tyre ose në përshtatjen me rolet publike që mbajnë ose kërkojnë.*

Seksioni 4 (pika 5)

4.5 *Të gjitha lajmet e transmetuara të publikohen në mënyrë objektive dhe të paanshme.*

Ankesa të tjera mbi emisionet në trajtimin e ngjarjes:

Ankuesi pretendon se emisioni ka transmetuara pjesë audio nga gjykimi, kur seanca ka qenë me dyer të mbyllura, ka intervistuar bashkëshorten e të ndjerit duke i mbuluar fytyrën, si dhe pretendon për disa fakte të pavërteta; si prerja e mandatit të lirit pas 85 orësh në arrest ndërsa emisioni publikoi se ky është mbajtur vetëm 24 orë në arrest; si dhe përmendja e emrit të të birit për kryerjen e pagesës e masës së sigurisë.

Zoti A.A. shprehej ndër të tjera se "në asnjë moment nuk jam kontaktuar nga redaksia e emisionit "Boom" për t'u prononcuar lidhur me këtë çështje, **ç'ka** i bën këto kronika kryekëput të njëanshme dhe jo objektive".

Menjëherë pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialet filmike të dy emisioneve të transmetuara nga "Ora News" në datat e pretenduara nga ankuesi. Pas shqyrtimit të materialit video, Këshilli i Ankesave konstatoi se emisioni "Boom" ka trajtuar ngjarjen pas denoncimit të familjarëve të viktimës.

Emisioni "Boom" në Televizionin "Ora News" ka intervistuar vëllain e viktimës i cili pretendon se po manipulohen provat e aksidentit dhe ai ishte paraqitur pranë redaksisë së këtij televizioni me shpresë të zgjidhjes së këtij problemi. Më pas, një gazetare e emisionit ka shkruar në terren pranë vendit të ngjarjes duke u përpjekur të na sjellë ngjarjen të rindërtuar si ajo ndodhi. Tragjedia fatale për viktimën sillet në një pamje 3D nga ana teknologjike, duke paraqitur sipas tyre versionin e ngjarjes. Gjatë kronikës së tij, emisioni "Boom" publikoi vendimin e Gjykatës së Fierit që liroi të akuzuarin A.A. kundrejt garancisë pasurore.

I vëllai i viktimës pretendon se bëhet fjalë për një aksident me pasojë vdekjen dhe shpreh shqetësimin se Prokuroria në Fier nuk ka dhënë masën e duhur të sigurisë. Ai ankohet edhe për aktin e ekspertizës të ekspertëve të Prokurorisë së Përgjithshme, duke pretenduar se eksperti ka nxjerrë si shkaktar të aksidentit *kushtet atmosferike*. Nisur nga kjo, i vëllai i viktimës i bën një apel Prokurorisë së Fierit dhe i kërkon asaj rivlerësim të ekspertizës.

Stafi i gazetarëve ndërkohë ka intervistuar një dëshmitar të ngjarjes, bashkudhëtar të viktimës, gjatë aksidentit. Gjatë intervistës ai pretendon se nuk ka pasur reshje të shumta shiu dhe se ka qenë shpejtësia e automjetit të drejtuar nga autori i dyshuar i ngjarjes -

150 kilometra në orë - shkaku i aksidentit. Emisioni ka publikuar aktine ekspertizës, i cili veçon se automjeti përgjegjës për aksidentin, ka qenë me 72 kilometra/orë, duke hedhur dyshime serioze për falsifikim situatash. Nisur nga ky fakt, vëllai i viktimës apelon për drejtësi si dhe pretendon se falsifikimi i shkaqeve të ekspertizës po ndihmon autorin e aksidentit, si dhe po dëmton interesat e familjes së viktimës, e cila duhet të përfitonte nga siguracioni. Me aktin e ekspertizës së Prokurorisë familja e viktimës mund të mos përfitojë.

Në përfundim, pas marrjes së ankesës dhe këqyrjes së materialeve filmike, Këshilli i Ankesave çmoi se emisioni "Boom" në TV "Ora News" ka trajtuar një ngjarje me interes publik, nisur nga fakti se kemi të bëjmë me humbje jete njerëzore, si dhe trajtim të çështjeve të tjera po aq më interes publik, si aksidentet rrugore dhe mungesa e drejtësisë.

Nisur nga pretendimi i ankuesit për shkeljen e privatësisë, Këshilli i Ankesave çmon se interesi publik në këtë rast ka më shumë rëndësi. Gjatë shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli konstatoi se emisioni nuk ka cenuar privatësinë e ankuesit.

Në pikën 3.2, të Kodit të Transmetimit, thuhet se *"identifikimi i një biznesi apo një individi në mënyrë indirekte apo aksidentale në raportimin e një ngjarjeje me interes publik mund të publikohet, përveç rasteve kur vërtetohet se kjo mund të shkaktojë dëm direkt apo paragjykim ndaj tyre"*.

Po ashtu, në fund të emisionit, drejtuesja e saj ka theksuar se emisioni "nuk po bëhet për të dënuar dikë, sepse me këtë merren strukturat e drejtësisë", duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të pabalancuar, të dhënies së fakteve të pavërteta në emision dhe të mos kontaktimit të tij në asnjë rast nga emisioni "Boom", Këshilli i Ankesave i kërkoi Televizionit "Ora News" që t'i ofrojë mundësinë ankuesit të paraqesë pretendimet e tij, sipas ligjit dhe një praktike të mëparshme.

Në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Ankesave, me shkresën numër 1481/2 të datës 21.05.2018, autorja e emisionit "Boom", Fiori Dardha shprehet se "Emisioni dhe më herët ka shprehur gatishmërinë për t'i dhënë zotit A.A. mundësinë për t'u shprehur" duke shtuar se "Emisioni do të vazhdojë ta ketë këtë gatishmërinë për t'i dhënë ankuesit A.A. mundësinë për të shprehur pretendimet e tij".

Vlen të theksohet se ankuesi nuk ka ushtruar të drejtën e përgjigjes bazuar në nenin 53 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Si përfundim, Këshilli i Ankesave vlerëson se emisioni "Boom" në "Ora News" trajtoi një çështje sensitive dhe që përbënte interes publik por në të njëjtën kohë duke i kërkuar këtij televizioni që t'i ofrojë mundësinë ankuesit për të paraqitur pretendimet e tij, nisur nga Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 33, pika b) ku përcaktohet qartësisht se *"OSHMA duhet të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme"*.

Për sa më sipër, në këto kushte, Këshilli i Ankesave ka ezauruar rolin e tij ligjor në lidhje me ankesën e shtetasit A.A.



Ankesa e paraqitur: **Shtetasja E.S**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Të gjitha

Tjetër

22.02.2018

Ankesa me
subjekt
komunikimet
me natyrë
tregtare

1. Programi

Shtetasi E.S. iu drejtua me një kërkesë për informacion Autoritetit të Mediave Audiovizive mbi disa aspekte etike në përmbajtjet e reklamave, nisur nga një kërkim shkencor që ai vetë kish ndërmarrë.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet duke u bazuar mbi parimet dhe rregullat e ligjit për të drejtën e informimit dhe nuk kategorizohet në ankesat mbi përmbajtjet audiovizive, përcaktuar në ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi kërkoi informacion në lidhje me aspektet etike të reklamës dhe promovimit si dhe një informacion për rastet kur Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) ka ndaluar transmetimin e reklamave në medias për shkak të shkeljes së etikës në to.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, në përgjigje të kësaj kërkesë, informoi shtetasin se Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), si struktura kryesore që mbikëqyr respektimin e Kodit të Transmetimit, ka trajtuar deri tani një rast reklame, e cila u ndalua nga transmetimi për arsye etike. Bëhet fjalë fundin e vitit të kaluar (2017), ku pati shumë ankesa dhe reagime ndaj reklamës për një produkt farmaceutik, reklamë që transmetohej në disa nga mediat audiovizive në Shqipëri.

AMA i kërkoi kompanisë ndërhyrjen në përmbajtjen e reklamës për produktin "Brufen", me qëllim shmangien e pasazheve që përmbanin skena dhune të skajshme dhe artificiale, pasazhe këto të evidentuara edhe nga Këshilli i Ankesave, gjatë shqyrtimit të reklamës.

Këshilli i Ankesave vlerësoi se, dy ishin pasazhet që krijojnë shqetësime të dukshme tek shikuesit, shqetësime vizive dhe audiovizive: skena e torturës dhe klithmat e personazhit të reklamës.

Kompanisë iu kërkua të ndërhynte në përmbajtjen e reklamës në fjalë, për të ofruar një version tjetër, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, por nuk pati një të tillë. Ndaj, AMA vendosi ndalimin e transmetimit të reklamës. Kjo e fundit nuk transmetohet më në mediat audiovizive shqiptare.

Subjekti audioviziv

Televizioni Klan

Programi

"Në kurthin e Piter Pan"

Data

1. Programet

"Në shtëpinë tonë" është një emision mëngjesi që transmetohet në Televizionin "Top Channel", dhe ka si qëllim të informojë publikun shqiptar mbi produktet e vendit tonë dhe t'i japë prioritet konsumit të prodhimit vendas.

Ndërsa "Në kurthin e Piter Pan" është një emision mbrëmjeje që transmetohet në Televizionin "Klan", ku personalitete të njohur vihen përballë pyetjeve të një grupi fëmijësh.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi ligjin nr. 8528, datë 23.09.1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji", Ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", si dhe Kodin e Transmetimit, i cili siguron që reklamën, shitjet e drejtpërdrejta...dhe

format e tjera të paraqitjes tregtare, të përdorura në çdo shërbim transmetimi, veçanërisht ato që lidhen me çështje që mund të jenë drejtpërsëdrejti ose jo në interes të të miturve, duhet të ruajnë interesin e tyre, duke pasur kujdes të veçantë për shëndetin e tyre.

3. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja sjell në vëmendje dy emisionet televizive "Në shtëpinë tonë" dhe "Në kurthin e Piter Pan", transmetuar përkatësisht në "Top Channel" dhe "Klan", ku në ditë të ndryshme janë promovuar ushqimet për bebe, prodhuar nga një kompani, e cila është dhe sponsor i emisioneve.

Sipas ankueses, "firma e prodhimit bën reklamë të zgjeruar, një herë në javë, për ushqimin e bebeve 4-6 muajsh, pa pasur as më të voglin shqetësim".

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vëzhgoi dy emisionet televizive, ku transmetohej reklama për ushqimin e bebeve.

Këshilli i sugjeroi Autoritetit të Mediave Audiovizive t'i kërkonte mendim Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), duke qenë se Ligji nr. 8528 datë 23/09/1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji", i ndryshuar, rregullon tregtimin e zëvendësuesve të qumështit të gjirit për të ushqyerit e fëmijëve.

ISHSH, në përgjigjen e tij, të dërguar në AMA, nënvizon se, Ligji nr. 8528, datë 23.09.1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji", i ndryshuar, nenin 4 përcakton se: *"Prodhuesve dhe shitësve u ndalohej reklama dhe promovimi i produkteve të përcaktuara në nenin 2, pika ç) duke përfshirë këtu paraqitjen speciale, vizuale në ekrane dhe nëpërmjet internetit e mediave sociale, reklamën për ulje çmimi, çmimet stimuluese, shitjet speciale, ulje çmimi me kushte të veçanta apo dhuratat, "kampionë të produkteve të caktuara", si dhe promovimi i tyre në një qendër shëndetësore apo institucion tjetër të sistemit shtetëror ose privat".*

ISHSH thekson se, në kuptim të nenit 2, pika ç, të ligjit nr. 8528, datë 23.09.1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji", i ndryshuar, me "Produkt i përcaktuar për shitje" kuptohet:

- Formulë për foshnjat, e cila nënkupton qumështin ose një produkt të ngjashëm me qumështin, me origjinë shtazore ose

bimore, i përgatitur industrialisht, që tregtohet për ushqimin e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël, nga lindja deri në gjashtë muaj.

- Formulë pasuese, e cila nënkupton qumështin ose një produkt të ngjashëm me qumështin, me origjinë shtazore ose bimore, i përgatitur industrialisht, që tregtohet si ushqim për foshnjat dhe fëmijët mbi gjashtë muaj.
- Çdo produkt tjetër, i shitur për ushqimin e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël.

Neni 46, pika 2, i Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar parashikon se: "Kodi i Transmetimit siguron që ... reklamën, shitjet e drejtpërdrejta, materialet e shitjeve të drejtpërdrejta, sponsorizimet dhe format e tjera të paraqitjes tregtare, të përdorura në çdo shërbim transmetimi, veçanërisht ato që lidhen me çështje që mund të jenë drejtpërsëdrejti ose jo në interes të të miturve, duhet të ruajnë interesin e tyre, duke pasur kujdes të veçantë për shëndetin e tyre".

Ky detyrim përcaktohet po ashtu edhe në Kodin e Transmetimit për median audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 221, datë 01.12.2017, në seksionin për reklamën dhe fëmijët.

Bazuar sa më sipër, AMA u kërkoi dy televizioneve ndërprerjen e transmetimit të kësaj reklame dhe u tërhoqi vëmendjen për të mos përsëritur raste të ngjashme, që bien ndesh me kërkesat ligjore.

Ankesa e paraqitur: **Nga një kompani e interesuar për të reklamuar produktet e saj në mediat audiovizive në Shqipëri**

1. Përmbledhje e kërkesës

Kompania, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), shtronte pyetjen nëse lejohej reklamimi i produktit "Vapes" në TV-të në Shqipëri dhe nëse jo, cila është baza ligjore që ndalon reklamimin e këtij produkti?

Sipas kompanisë, bëhet fjalë për produktin "Vapes" që njihet gjerësisht si "cigarja elektronike".

2. Përgjigjja

Duke patur parasysh një rast të ngjashëm, të disa muajve më parë, kur një subjekt kërkonte të dinte nëse lejohej reklama për cigaren elektronike, AMA u kërkoi mendim dy institucioneve shëndetësore në vend.

Përgjigjja e tyre e unifikuar ishte:

Bazuar në Ligjin nr. 9636, datë 06/11.2016, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar, neni 13 përcakton se "Ndalohen reklama dhe promovimi i produkteve të duhanit nëpërmjet medias së shkruar, transmetimeve televizive e radiofonike dhe shërbimeve të shoqërive të informacionit. Ndalohen reklama dhe promovimi i çdo lloji dhe forme tjetër të produkteve të duhanit. Ndalohet, për qëllime reklame apo promovimi, botimi i fotografive, vizatimeve etj., në të cilat shfaqen persona që pinë duhan dhe i imazheve

që krijojnë përshtypje të gabuar te publiku për karakteristikat e produkteve të duhanit, efektet e përdorimit të tyre në shëndet, rreziqet dhe/ose dëmet. Nuk përbëjnë reklamë dhe promovim të produkteve të duhanit librat teknikë, revistat dhe botimet e tjera profesionale për duhanin".

Edhe Ligji 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 43, pika 4, përcakton se "Të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për cigaret dhe produktet e tjera të duhanit janë të ndaluara".

Duke iu referuar sërish Ligjit nr. 9636, datë 06/11.2016, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar, në nenin që trajton përkufizime, përfshirë edhe produktet e duhanit, theksohet se "Nikotinë janë alkaloidë nikotinique helmuese që gjenden në tymin e duhanit dhe veprojnë në sistemin nervor". Edhe cigaret elektronike, referuar përkufizimit në direktivën <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF?uri=CELEX:32014L0040@from=EN>, neni 2, pika 16 e në vijim, përmbajnë këtë lëndë helmuese.

Bazuar sa më sipër, subjektit kërkues iu dha përgjigjja se reklamimi i cigares është i ndaluar.



Ankesa e paraqitur: **Shtetasja E.V.**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Të gjitha

Tjetër

10.03.2018

1. Programi

Ankesa e shtetasit E.V. nuk kishte të bënte me përmbajtjen e një programi të caktuar, por me transmetimin e prodhimeve të ish-Kinostudios "Shqipëria sot", përmbajtje kinematografike të prodhuar para viteve '90.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi parimet e Ligjit "Për të drejtën e informimit" dhe nuk kategorizohet në ankesat mbi përmbajtjen audiovizive, të përcaktuar në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Kodin e Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Në ankesën e tij, shtetasi shprehet se për shkak të disa qëndrimeve publike mbi çështjen e transmetimit apo mos-transmetimit të filmave të kohës së komunizmit, u krijua një debat, por që në thelb nuk i ofroi opinionit

informacione konkrete se si operohet me to. Në kërkesën e tij, ai kërkoi përgjigje për:

1. Sa është numri i operatorëve, të cilët kanë depozituar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive kontrata të transmetimit të filmave të ish-Kinostudios Shqipëria e Re? (kontrata këto të lidhura me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë-QKK/ Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit-AQSHF)?
2. A ka depozituar Radio-Televizioni Shqiptar kontrata në lidhje me transmetimin e filmave të ish-Kinostudios "Shqipëria e Re"?
3. A ka AMA të dhëna specifike se sa është numri i operatorëve që transmetojnë këto filma?
4. A ka pasur ankesa nga operatorët, ose nga audienca për pakënaqësi apo parregullsi të transmetimit të filmave të ish-"Kinostudios Shqipëria e Re"? Nëse po sa ka qenë numri i tyre?

Ankesa të
tjera

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Programeve në AMA, iu përgjigj pyetjes nr. 4 të shtetasit E.V. Në janar të vitit 2017, Instituti i Integritetit ish të Përndjekurve Politikë në Tiranë i drejtoi një shkresë zyrtare AMA-s, me shqetësimin për shfaqjen në TV të ndryshme të filmave të prodhuar gjatë kohës së diktaturës. Letra kërkonte ndalimin e transmetimit të tyre, sepse, siç shkruhej, "diskriminojnë dhe cenojnë dinjitetin e ish të përndjekurve nga regjimi komunist, në kuadër të respektimit të kësaj shkrese".

AMA e vlerësoi maksimalisht këtë ankesë dhe kërkoi një takim me zyrtarët e Institutit, takim që u realizua pas pak ditësh. Takimi zyrtar mes përfaqësuesve të dy institucioneve ishte shumë i dobishëm, me shkëmbim të lirshëm të mendimeve dhe propozimeve, duke u dakordësuar se kjo çështje kërkon dy aspekte thelbësore në trajtimin e saj. Së pari, të bëhet një vlerësim i krijimtarisë filmike dhe dokumentare të periudhës së para viteve '90, dhe së dyti duhet një vendimmarrje për mënyrë e transmetimit publik të saj. Nuk bëhet fjalë për produkte audiovizive të televizioneve, por janë vepra kinematografike që janë prodhuar në një kontekst tjetër. Vlerësimi dhe vendimmarrja janë dy procese

që e tejkalojnë kompetencën ligjore dhe rregullative të AMA-s.

Vlerësimi duhet bërë nga një trupë, strukturë, apo organizëm ndërinstitucional, ku të përfshihet ekspertizë e shumëllojshme, profesionale, historike, artistike, akademike etj. Kurse vendimmarrja për këtë çështje i takon Kuvendit të Shqipërisë. Të ndalosh një krijimtari artistike, të ndalosh filma të prodhuar në një kohë tjetër duhet bërë pas një vlerësimi profesional. Sepse duhet së pari që të qartësohen se cilët nga filmat dhe dokumentarët e kohës së diktaturës nuk duhen të transmetohen më; cilët prej tyre duhet të transmetohen në orare të përcaktuara; cilët pa kufizim orar. Edhe vendimmarrja duhet të jetë e Kuvendit, pasi bëhet fjalë për një çështje delikate, për të cilën vetëm ky institucion, që përfaqëson shtresime të ndryshme të publikut, përfshi dhe vetë ish të përndjekurit, ka kompetencë të marr vendim. Kjo u vlerësua nga AMA në takim si rruga e duhur, ku duhet vlerësim dhe pastaj vendimmarrje.

Nëse ka vlerësim të kësaj krijimtarie dhe më pas vendimmarrje konkrete, atëherë zbatimi i ligjit është detyra e AMA, duke monitoruar dhe ndjekur me rigorozitet performancën e subjekteve audiovizive se sa ato e respektojnë vendimin e Kuvendit të Shqipërisë.

Ankesa e paraqitur: **Shtetasja A.B.**

1. Përmbledhje e ankesës

Zoti A.B., me banim në rrethin e Korçës, ankohej se prej 5 muajsh që sinjali i transmetimit të kanaleve televizive në këtë rreth ka kaluar në sistemin digjital, në fillim fuqia e sinjalit ka qenë e mirë, por kohët e fundit kjo fuqi ka rënë ndjeshëm, duke vështirësuar shikimin e kanaleve. Ankuesi pretendon se ka informacione që fuqia e sinjalit ulet qëllimisht.

2. Delegimi i ankesës

Këshilli i Ankesave vendosi që ankesën e qytetarit A.B. t'ia kalojë Drejtorisë së Mbikëqyrjes në AMA për verifikime në terren dhe ndjekje të mëtejshme të saj.

Ankesa e paraqitur: **reagime në rrjetet sociale**

Subjekti audioviziv

Radio-Televizioni Shqiptar

Programi

Data

1. Përmbledhje e ankesave

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), si organ rregullator i veprimtarisë së mediave audiovizive, janë depozituar disa ankesa ndaj komentatorit sportiv, z. K.G.(punonjës i Radio-Televizionit Shqiptar) lidhur me disa qëndrime të tij nacionaliste në komentet sportive dhe debate televizive mbi tifozerinë e tij në Kampionatin Botëror të Futbollit 2018. Sipas ankuesve, shpesh qëndrimet e tij publike janë provokuese për krenarinë kombëtare të shqiptarëve.

Sipas ankuesve, shpesh qëndrimet e tij publike janë provokuese për krenarinë kombëtare të shqiptarëve. Ne po citojmë disa nga ankesat më poshtë: *"...do ta quaja provokim që një person publik, i cili paguhet nga taksat tona, bën haptas në televizionin publik tifo në mbështetje të Serbisë dhe qarqeve antishqiptare ... Kjo është një propagandë sistematike e bërë nga ky person që është*

në mbështetje të hapur ndaj atyre që në çdo ndeshje thërrasin shqiptar i mirë, shqiptar i vdekur... ose dhoma gazi për shqiptarët...".

Ndërsa në një tjetër ankesë citohet: *"...shpreh indignatën e thellë që K. G., i cili paguhet nga taksat e mia bën propagandë antishqiptare në televizionet shqiptare...por jo vetëm kaq...". "Një njeri, i cili, herë pas here në televizionin publik deklaron gjëra të papëlqyeshme që ofendojnë publikun, ... i njëjti provokon në ndjenja kombëtare; nuk duhet të tolerohet..."*.

2. Kërkesa për RTSH-në

Duke i dërguar, përmes një shkrese drejtuar RTSH-së disa prej ankesave, si dhe bazuar mbi shqetësimin sensitiv të ankuesve dhe numrin e tyre të konsiderueshëm, AMA i kërkoi Radio-Televizionit Shqiptar trajtimin e këtij rasti bazuar në Kodin e Etikës të RTSH-së.



Ankesa e paraqitur: **Shtetasja M.D.**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv	Programi	Data
...	Transmetimet audiovizive	09.03.2018

Ankesat e rrëzuarat

1. Programi

Ankesa e shtetasit M.D., e ardhur dorazi në Autoritetin e Mediave Audiovizive, nuk kishte të bënte me shkeljen e rregullave dhe parimeve etike në përmbajtjet audiovizive. Sipas tij, teknologjia e transmetimeve audiovizive atij i ka sjellë shqetësime shëndetësore dhe ndonëse nuk specifikonte se ç'mund të bëjë institucioni, kërkonte që shqetësimi i tij të merrej parasysh.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi parimet e ligjit për të drejtën e informimit dhe nuk kategorizohet në ankesat mbi përmbajtjet audiovizive, të përcaktuara në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe Kodin e Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi pretendon se teknologjia e transmetimeve audiovizive i ka sjellë probleme shëndetësore dhe prej 4 vitesh merrte medikamente mjekësore. Shtetasi pretendonte në ankesën e tij se ka një vërtetim mjekësor se ai është vuan nga depresioni i vazhdueshëm dhe pretendonte se pasojat vinin për shkak të teknologjisë së transmetimit prej 24 orësh të programeve televizive. Ndër të tjera ai sugjeronte shkurtimin e orarit të transmetimit për subjektet audiovizive.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave e mori në shqyrtim ankesën e tij dhe në përgjigje të saj konstatoi se; Bazuar në Ligjin nr. 97/2013 'Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, neni 6 përcakton se, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 1, ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre. AMA, në ushtrimin e funksioneve të veta, bazuar në nenin 18 të ligjit të sipërcituar siguron:

a) që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve;

b) ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias, etj. Ndër të tjera AMA nxit:

a) promovimin e programeve të shumëllojshme dhe pa pagesë;

b) sigurimin e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së lartë të programeve dhe me risi nga OSHMA-të publike e private.

Ndaj nisur nga sa më sipër, sqarojmë se nuk është pjesë e ligjit 97/2013 kufizimi i orareve të transmetimeve audiovizive. Transmetimet audiovizive rregullohen me anë të një programacioni të larmishëm kundrejt zbatimit të parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive, sipas nenit 4 të ligjit në fjalë.



*Kërkesë për
informacion*

Ankesa e paraqitur: **OSHMA**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv

Të gjitha

Programi

Transmetim reklame

Data

22.02.2018

1. Programi

Ankesa e ardhur në emër të një OSHMA-je ka të bëjë me interpretimin e ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit përsa i përket transmetimit të një reklame për cigaret elektronike.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi parimet e ligjit për të drejtën e informimit dhe mund të kategorizohet në ankesat mbi përmbajtjet audiovizive, të përcaktuar në ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit. Po ashtu, ankesa përfshin edhe ligjin nr.9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

3. Përmbledhje e ankesës

OSHMA kërkon nga Autoriteti i Medias Audiovizive një interpretim të ligjit në lidhje me një produkt për reklamimin e tij, cigare elektronike. Në ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar konkretisht neni 42, pika 4, transmetimi i reklamave për cigaret dhe produktet e tjera të duhanit janë të ndalura.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Programeve shqyrtoi kërkesën për të interpretuar kërkesën e ligjit. AMA iu drejtua zyrtarisht dy institucioneve të tjera, të cilat kanë detyrim për zbatimin e Ligjit nr.9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", konkretisht Institutit të Shëndetit Publik dhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Nga dy institucionet, AMA mori një përgjigje të njëjtë në lidhje me interpretimin e ligjit përsa i përket mundësisë së transmetimit të një reklame për cigaret elektronike. Nisur nga përgjigja e dy institucioneve, AMA informoi OSHMA-në e interesuar se: bazuar në ligjin nr.9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar, neni 13: "Ndalohen reklama dhe promovimi i produkteve të duhanit nëpërmjet medias së shkruar, transmetimeve televizive e radiofonike dhe shërbimeve të shoqërive të informacionit. Ndalohen reklama dhe promovimi i çdo lloji dhe forme tjetër të produkteve të duhanit. Ndalohet, për qëllime reklame apo promovimi, botimi i fotografive, vizatimeve etj., në të cilat shfaqen persona që pinë duhan dhe i imazheve që krijojnë përshtypje të gabuar te publiku për karakteristikat e produkteve të duhanit, efektet e përdorimit të tyre në shëndet, reziqet dhe/ose dëmet".

Ankesa e paraqitur: **Nga disa individë**

Ardhur në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv

Të gjitha

Programi

Transmetim reklame

Data

22.02.2018

1. Programi

Ankesat kanë ardhur nga disa individë, të cilët shprehin shqetësimin mbi transmetimin e një reklame nga një kompani bastesh sportive, gjatë transmetimit të ndeshjeve të futbollit të Kampionatit Botëror "Rusi 2018".

2. Kategoria

Ankesat ngrihet mbi parimet e Ligjit nr. 155/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të komunikimeve tregtare, të sanksionuara në Ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Kodin e Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Ankuesit kërkojnë ndalimin e reklamave të kompanive sportive, që transmetohen në mediat audiovizive në Shqipëri, dhe që sipas tyre, nxisin ndjenjën e kumarit.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, ankesat e paraqitura dhe u bëri me dije ankuesve se, publiciteti i lojërave të fatit, përfshirë edhe bastet sportive, rregullohet prej Ligjit nr. 155/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe institucioni i ngarkuar për zbatimin e tij është Agjencia për Mbikëqyrjen e Lojërave të Fatit, të cilit AMA i ka kërkuar trajtimin e ankesave në fjalë.



Fund

**AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.
www.ama.gov.al

këtej, mbështetur në Kodin
të miratuar nga A
e Audiovizive i cili përm
parimet, rregullat, kërkes
e transmetimeve audioviz
ën e Shqipërisë, Këshilli i
n të vëzhgojë me kujdes se
të mirëpërcaktuara për p
tëmet audiovizive zbatoh
i Këshillit të Ankesave i
kohësh ka qenë i mundur
audioviziv si këshillues i pë
meve audiovizive, është n
të cilin raportohen resul
vara nëpërmjet të cilave dy
arimet, rregullat, kërkesat